REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
02/Nr. Prot. 2-180/1637
Nr. i faq. 2
Data 06/03/2026

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës
Nr. 002/16
Datë:27.02.2026

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 4 dhe nenit 7 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, si dhe në përputhje me Statutin e Komunës së Junikut dhe kompetencat e komunës në fushën e arsimit parauniversitar, Kuvendi i Komunës së Junikut në mbledhjen e tijë të rregullt të mbajtur më 27.02.2026 nxjerrë:

V E N D I M
Për inicimin e procedurave për hartimin e planit zhvillimor të arsimit në Komunën e Junikut 2026-2030

I. Miratohet inicimi i procedurave për hartimin e Planit Zhvillimor të Arsimit në Komunën e Junikut për periudhën 2026–2030.

II. Plani Zhvillimor i Arsimit është dokument strategjik që përcakton objektivat, prioritetet dhe masat për zhvillimin dhe përmirësimin e sistemit të arsimit parauniversitar në territorin e Komunës së Junikut.

III. Qëllimi i hartimit të këtij plani është përmirësimi i cilësisë së arsimit parauniversitar, zhvillimi i kapaciteteve institucionale në institucionet arsimore, përmirësimi i infrastrukturës arsimore dhe kushteve të mësimdhënies, rritja e përfshirjes dhe barazisë në arsim dhe harmonizimi i politikave arsimore lokale me politikat arsimore kombëtare.

IV. Për hartimin e Planit Zhvillimor të Arsimit do të themelohet Grupi Punues Komunal, i përbërë nga përfaqësues të Drejtorisë Komunale të Arsimit, përfaqësues të institucioneve arsimore, përfaqësues të prindërve dhe komunitetit, përfaqësues të shoqërisë civile dhe ekspertë të fushës së arsimit.

V. Procesi i hartimit të planit do të përfshijë analizën e gjendjes aktuale të arsimit në komunë, identifikimin e sfidave dhe prioriteteve zhvillimore në sektorin e arsimit, konsultime publike me palët e interesit, harmonizimin me politikat dhe strategjitë kombëtare të arsimit dhe hartimin e planit të veprimit me masa konkrete dhe afate kohore për zbatim.

VI. Plani Zhvillimor i Arsimit, pas hartimit, do t'i paraqitet Kuvendit të Komunës së Junikut për shqyrtim dhe miratim.

VII. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës së Junikut, përkatësisht Drejtoria për Arsim,Kulturë.Rini e sport, e cila do të koordinojë procesin e hartimit të planit zhvillimorë.

VIII. Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

- MAPL,
- Kryetari i Komunës së Junikut,
- Drejtoria për Arsim,Kulturë,Rini e Sport,
- Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut, dhe
- Arkivi i Komunës së Junikut

Kryesuesi i Kuvendit
z. Leonard Llolluni